



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

UDHËZIM PLOTËSUES

3065

Nr. 8/1 Datë 6/31/7

“PËR

**NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË UDHËZIMIN PLOTËSUES NR. 8, DATË
13.01.2017 ‘PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2017’**”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 21, të ligjit nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, të VKM nr.171, datë 03.03.2016 “Për një ndryshim në Vendimin nr.841, datë 27.09.2013 të Këshillit të Ministrave ‘Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave’” dhe në vijim të Udhëzimit të ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 2, ministri i Financave;

UDHËZON:

Në Udhëzimin Plotësues nr. 8, datë 13.01.2017 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2017”, në kreun I. “Procedura specifike shtesë për zbatimin e Buxhetit të Shtetit” bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 13, gërma “c” shtohet fjalia si me poshtë:

“Fondet e investimeve të akorduara për Agjensitë e Zhvillimit Rajonal për infrastrukturën vendore nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve të cilat të rezultojnë të papërdorura në fund të vitit 2016, do të mbarten në vitin pasardhës në të njëjtën strukturë buxhetore, pas rakordimeve përkatëse të degës së thesarit me Agjensitë e Zhvillimit Rajonal”.

2. Në pikën 14, riformulohet paragrafi i parë:

“Gjatë vitit 2017 akordimi i fondeve për financimin e projekteve të reja dhe në vazhdim nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për infrastrukturën vendore dhe sipas shtyllës II “Shqipëria dixhitale” dhe shtyllës III “Mbështetje për ekonominë” do të bëhet sipas kësaj procedure:”

3. Në pikën 14, gërma “a” shtohet togfjalëshi në fund të paragrafit:

“dhe me kod programi 06210”.

4. Në pikën 14, gërma “b” ri-formulohet me këtë përmbajtje:

“b”. Për projektet e reja dhe në vazhdim të infrastrukturës vendore, shtyllës II “Shqipëria Dixhitale” dhe shtyllës III “Mbështetje për ekonominë” me autoritet kontraktues njësitë e qeverisjes qendrore, fondet për vitin 2017 do të alokohen me Vendim të Këshillit të Ministrave duke i rishpërndarë nga Ministria e Zhvillimit Urban në institucionet qendrore. Përgatitja e projektvendimit inicohet nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe paraqitet për mendim në Ministrinë e Financave”.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR

